

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim

... një kuadër i vetëm dhe i unifikuar strategjik

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013 (SKZHI) përfaqëson dokumentin strategjik themelor të Shqipërisë, miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave në Mars 2008. Kjo strategji harmonizon për herë të parë perspektivën e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror, integrimin në strukturat e Bashkimit Evropian dhe të NATO-s, si dhe arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit.

SKZHI-ja kristalizon vizionin afatmesëm dhe afatgjatë të zhvillimit të vendit në bazë të një procesi transparent dhe të hapur, i cili garanton përfshirjen e gjerë të shoqërisë civile, të qeverisjes vendore, të komunitetit të biznesit, të botës akademike dhe shkencore, të spektrit politik shqiptar dhe të grupeve të tjera të interesit. Zbatimi i SKZHI-së parashikon ndërtimin e politikës së analizës së kapaciteteve për të siguruar që qëllimet/objektivat e SKZHI-së të përkthehen në mënyrë të efektshme në politika konkrete dhe programe në nivel ministrie.

SKZHI-ja ndihmon procesin e buxhetimit afatmesëm, duke siguruar një udhëzim afatgjatë për shpërndarjen e burimeve në të gjithë planet afatmesme të shpenzimeve të sektorëve të ndryshëm. Lidhja e përcaktimit të buxhetit afatmesëm me përparësitë dhe qëllimet strategjike kombëtare afatgjata, në një proces të vetëm planifikimi strategjik, është objektivi kryesor i adoptimit të Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI) nga ana e Qeverisë Shqiptare. Përparësitë e SKZHI-së dhe procesi i PBA-së janë baza për programimin e Instrumentit të Para-aderimit (IPA) dhe ndihmës së ofruar nga donatorë të tjerë.

Mekanizmi monitorues për zbatimin e SKZHI-së dhe strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale është konsoliduar. Ai do të zhvillohet më tej me përtëritjen e **Grupeve Këshillimore për Strategjitë Sektoriale**, me angazhimin e shoqërisë civile dhe të aktorëve të tjerë për monitorimin e zbatimit të përparësive të strategjive sektoriale dhe për të konsultuar treguesit e performancës, që do të pasqyrohen në kërkesat për buxhet të ministrive përkatëse. **Grupi Kombëtar Këshillimor**, përbëhet nga përfaqësues të çdo Grupi të veçantë Këshillimor dhe është organi kryesor i palëve të interesuara jo-qeveritare, që do të monitorojnë zbatimin e SKZHI-së.

Raporti Vjetor i Progresit i SKZHI-së është një komponent i rëndësishëm i sistemit të monitorimit. Ai përmbledh përparimin dhe performancën e sektorit, në tri fusha kryesore: Integrimi në BE dhe në NATO; Demokratizimi dhe Sundimi i Ligjit; dhe Zhvillimi Ekonomik dhe Social.

Planet e Integruara të Ministrisë janë dokumente vjetore që nënvizojnë angazhimet kyç të PBA-së, duke përfshirë edhe angazhimet për integrimin në BE, legjislacionin e planifikuar, investimet e mëdha publike, masat antikorrupsion, dhe projektet e ndihmës së huaj.

Përgatitja e SKZHI-së u udhëhoq nga **parimi i pronësisë** së qeverisë.

Procesi i konsultimit të SKZHI-së është kryer dhe drejtuar **për herë të parë në Shqipëri** nga DEBASKON-i, me synimin që të mblidhen komentet e palëve të interesuara, të **identifikohen përparësitë strategjike** dhe të sugjerohet **shpërndarja e burimeve të ardhshme financiare**. **Debate TV dhe seminare** janë organizuar mbi këtë çështje.

38 strategji sektoriale dhe ndërsektoriale nga ministrinë e linjës kanë dhënë kontribut thelbësor për SKZHI-në.

Planet e Integruara të Ministrisë (PIM) përbëhen nga dy pjesë kryesore: Raporti Vjetor i Ministrisë, i cili thekson rezultatet e arritura kundrejt angazhimeve të PIM-it të vitit të kaluar; Plani i Monitorimit të Ministrisë, i cili përfshin një sërë objektivash kryesore dhe kërkesash ligjore për monitorim dhe raportim, në ujdi me ministrinë e linjës.